



BULETINI I ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHTETIT

NËNTOR 2024

BULETINI I ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHETIT

NËNTOR 2024

Në edicionin e këtij Buletini pasqyrohen aktivitetet e ZKPSH-së për muajin NËNTOR 2024

U.D. Kryeprokurori i Shtetit dhe Shefi i Misionit të Eulex-it flasin për çështje të sundimit të ligjit

Prishtinë, 7 Nëntor 2024 – Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka pritur në takim Shefin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Giovanni Pietro Barbano, me bashkëpunëtorë.



U.D. Kryeprokurori Kelmendi dhe Shefi i Eulex-it, z. Barbano, patën diskutime konstruktive dhe përmbajtjesore lidhur me çështjet e interesit të përbashkët, përfshirë këtu rëndësinë e avancimit të bashkëpunimit të ndërsjellë në proceset institucionale, nevojën për ruajtjen e pavarësisë së pushtetit gjyqësor ku bënë pjesë edhe sistemi prokurorial, si dhe ngritjen e koordinimit në çështjet që kanë të bëjnë me forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.



Duke e vlerësuar lartë angazhimin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë në monitorimin e punës së sistemit prokurorial, U.D. Kryeprokurori Kelmendi ka potencuar se EULEX

mbetët një nga partnerët me të rëndësishëm të institucionit të Prokurorit të Shtetit.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit dhe Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar vlerësojnë bashkëpunimin e ndërsjellë

Prishtinë, 12 Nëntor 2024 - Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka pritur në takim Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Jonathan Hargreaves, i shoqëruar nga Shefja e Sektorit të Sundimit të Ligjit, znj. Margaret Belof, dhe Zyrtarja për Zbatimin e Politikave në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Ambasadën Britanike, znj. Altina Besimi.



U.D. Kryeprokurori Kelmendi dhe Ambasadori Hargreaves patën diskutime të hapura dhe produktive për tema të interesit të përbashkët, përfshirë këtu të arriturat, sfidat dhe përpjekjet për tejkalimin e tyre në funksion të konsolidimit institucional, si dhe impaktin pozitiv të cilin e kanë partnerët ndërkombëtarë, përfshirë këtu edhe Mbretërinë e Bashkuar në proceset brenda sistemit prokurorial.



Duke vlerësuar lartë rolin dhe mbështetjen e Britanisë së Madhe të dhënë për institucionet e drejtësisë, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka theksuar se bashkëpunimi i ngushtë dhe i ndërsjellë me Ambasadën Britanike do të vazhdojë edhe në të ardhmen, me qëllim të avancimit të punës së institucionit të Prokurorit të Shtetit në funksion të fuqizimit të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit priti në takim Menaxherin e Projekti Rajonal të OSBE-së për Monitorimin e Proceseve Gjyqësore, z.Kahramon Sanginov

Prishtinë, 19 nëntor 2024 – Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi ka pritur në takim Menaxherin e Projektit Rajonal të OSBE-së për Monitorimin e Proceseve Gjyqësore, z.Kahramon Sanginov.



Gjatë këtij takimi, ata kanë diskutuar tema që janë me interes për sistemin prokurorial dhe qytetarët e Republikës së Kosovës, si dhe mundësitë e organizimit të aktiviteteve që ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka vlerësuar ndihëm dhe mbështetjen që Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) e ka dhënë dhe vazhdon ta jap për institucionin e Prokurorit të Shtetit, me ç'rast shprehu gatishmërinë që bashkëpunimi i deritanishëm të thellohet edhe në të ardhmen.



U.D. Kryeprokurori i Shtetit priti në takim studentë të fakulteteve juridike

Prishtinë, 19 nëntor 2024 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi ka pritur në vizitë një grup studentësh të fakulteteve juridike, juristë të rinj të Klinikës Ligjore të Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Gjatë kësaj vizite studentët u informuan nga U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi rreth rolit, përgjegjësisë dhe detyrave të Prokurorit të Shtetit në kuadër të sistemit të drejtësisë.



U.D. Kryeprokurori Kelmendi i njoftoi të pranishmit me mënyrën e funksionimit, strukturën organizative dhe kompetencat e Prokurorit të Shtetit, në përgjithësi e konkretisht për kompetencat e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, për sfidat dhe të arriturat e këtij institucioni, si dhe për të gjitha veprimet procedurale që prokurorët i ndërmarrin gjatë fazave të hetimit, ngritjes së aktakuzës deri

të dërgimi dhe përfaqësimi i akteve akuzuese në gjykatë.

Po ashtu, ata u njoftuan edhe për kompetencat e zyrave të veçanta që funksionojnë në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, siç janë: Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Njësia Ndërlidhëse e Përgjimeve dhe Zyra për Rikthimin e Aseteve.



U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi iu përgjigj edhe pyetjeve të studentëve lidhur me çështjet që ata kishin interes të informoheshin, e që ndërlidheshin me punën e përditshme të Prokurorit të Shtetit, ku dhe shkëmbyen biseda të përbashkëta profesionale nga fusha e drejtësisë penale.



Në fund, U.D. Kryeprokurori Kelmendi ka falënderuar studentët për vizitën në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, duke ju uruar suksese në rrugëtimin e tyre profesional si juristë të rinj, me ç'rast i ka inkurajuar ata që në të ardhmen të kontribuojnë profesionalisht në institucionet e drejtësisë.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit mori pjesë në lansimin e udhëzuesit për matjen e dënimit nga Gjykata Supreme

Prishtinë, 22 nëntor 2024 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi mori pjesë ceremoninë e lansimit të udhëzuesit për matjen e dënimit nga Gjykata Supreme.

Gjatë fjalës së tij në këtë ceremoni, U.D. kryeprokurori Kelmendi theksoi se miratimi i udhëzuesit për matjen e dënimit është një nga hapat me të rëndësishëm që sistemi i drejtësisë mund të bëjë në harmonizimin e praktikave në matjen e dënimit.



Për këtë qëllim edhe Kryeprokurori i Shtetit ka lëshuar një udhëzim të detyrueshëm, i cili e qartëson rolin dhe kontributin e Prokurorit të Shtetit në matjen e dënimit.

U.D. kryeprokurori Kelmendi potencoi se një obligim i tillë tanimë është formalizuar edhe më shumë me ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit prokurorit i jepet mundësia të propozoj edhe lartësinë e dënimit, andaj njoftoi se në çdo rast kur ka takime me kryeprokurorë dhe prokurorë iu bënë thirrje atyre që këtë udhëzues ta konsiderojnë si mjet më shumë vlerë për punën e tyre.



Tutje, Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi pohoi se ky udhëzues mundëson zbatimin e ligjit në mënyrë të drejtë dhe të balancuar, sepse çdo veprim i Prokurorit të Shtetit duhet të jetë në përputhje me parimet e drejtësisë, ligjet në fuqi dhe standardët e këtij udhëzuesi, duke shtuar se kjo nuk është një detyrë e thjeshtë, por është një përgjegjësi e madhe që kërkon përkushtim të pakushtëzuar për secilin.



Në fund të fjalës së tij, U.D. kryeprokurori Kelmendi, falënderoj Gjykatën Supreme, Departamentin e Drejtësisë në Ambasadën Amerikane –OPDAT dhe të gjithë ata që ndihmuan në finalizimin e këtij projekti madhor.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit diskuton me kryeprokurorët për trajtimin e rasteve të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar

Prishtinë, 26 nëntor 2024 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka mbajtur kolegjiun e rregullt me të gjithë kryeprokurorët e prokurorive të vendit, përfaqësues të prokurorive dhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Ambasadës së SHBA-së në Kosovë.

Në këtë takim u diskutua për çështjet penale që ndërlihen me bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë, sfidat për ekstradimin dhe dërgimin e ekspertizave jashtë vendit, me ç'rast U.D. Kryeprokurori Kelmendi ka kërkuar që këto raste të trajtohen me prioritet për të ngritur edhe imazhin e Prokurorit të Shtetit karshi institucioneve dhe partnerëve ndërkombëtarë.



Çështje tjetër me rëndësi që u diskutua në këtë takim ishte edhe kontrollet-bastisjet në procedurat hetimore. Poashtu gjatë këtij takimi u diskutua edhe për ekipet e përbashkëta hetimore, të cilat krijohen nga kryeprokurorët e prokurorive që përfshinë çështjet komplekse hetimore e që kërkohet bashkëpunim dhe ekspertizë përkatëse nga institucionet tjera ligjzbatuese.



Prokurorja Laura Pula, paneliste në Konferencën “Të bashkuar kundër dhunës – Mjaft!”

Prishtinë, 26 nëntor 2024 - Në kuadër të shënimit të fushatës globale “16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore”, prokurorja në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, znj. Laura Pula, ishte pjesë e panelit të konferencës “Të bashkuar kundër dhunës – Mjaft!”, të organizuar nga Ministria e Drejtësisë, në të cilën është diskutuar për dhunën gjinore dhe dhunën në familje.

Në adresimin e prokurores Pula para të pranishmeve, e cila njëherësh është edhe Koordinatore Kundër Dhunës në Familje dhe

Dhunës me Bazë Gjinore në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, ajo nënvizoi rolin e madh të Prokurorit të Shtetit në trajtimin e dhunës së raportuar, duke siguruar hetimin dhe ndjekjen penale me prioritet tek rastet e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. “Këshilli Prokurorial iu ka dhënë prioritet këtyre rasteve qysh nga viti 2018 kur ka caktuar prokurorë të specializuar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, të cilët merren veç me rastet e dhunës në familje”, tha znj. Pula.



Me këtë rast, znj. Pula vuri theksin e saj në analizimin e trajtimit të rasteve të dhunës me baza gjinore, duke thënë se nëse analizojmë rastet e vrasjeve në familje, atëherë shpeshherë gjejmë faktorin e recidivizimit dhe vrasja e gruas ose femicidi ndodh si akt i fundit i dhunës që përjeton një grua pas një dhune sistematike të ushtruar ndaj saj dhe do të duhet avokim dhe pjesëmarrje aktive e gjithë shoqërisë për të krijuar zgjidhje afatgjata dhe për të luftuar këto vepra.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit takon përfaqësuesit e Programit Global për Luftimin e Flukseve Financiare të Paligjshme (IFF)

Prishtinë, 27 Nëntor 2024 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, priti përfaqësuesit e Programit Global për Luftimin e Flukseve Financiare të Paligjshme (IFF), që vepron nën agjencinë gjermane të zhvillimit GIZ, të kryesuar nga znj. Marina Kovačić dhe z. Ilija Bundaleski.

Gjatë takimit, përfaqësuesit e IFF-it prezantuan fushat kryesore të fokusit të programit, përfshirë adresimin e flukseve financiare të paligjshme, hetimet financiare, rikthimin e aseteve, koherencën e politikave dhe përmirësimin e kushteve për bashkëpunim ndër-sektorial, ndër-shtetëror dhe ndër-rajonar, me theks të veçantë në Ballkanin Perëndimor.



Në këtë kontekst, U.D. Kryeprokurori Kelmendi i informoi pjesëmarrësit për funksionalizimin e Zyrës për Rikthimin e Aseteve, nënvizoi nevojën për thellimin e bashkëpunimit dhe theksoi lehtësimin e vendosjes së kontakteve me partnerët ndërkombëtarë. Një fokus i veçantë iu kushtua fushave si rikthimi i aseteve, lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Z. Kelmendi shprehu mirënjohjen për përfaqësuesit e Programit Global për Luftimin e Flukseve Financiare të Paligjshme (IFF) për vizitën në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe rikonfirmoi gatishmërinë e tij për bashkëpunim të ndërsjellë në të ardhmen.

Urimi i U.D. Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, për nder të 112 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë

Prishtinë, 28 Nëntor 2024 -

Të nderuar bashkëkombës,

Sot, me rastin e shënimit të 112 Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, kujtojmë sakrificën e shumë brezave dhe nderojmë idealin dhe veprën e të gjithë atyre që në kohëra dhe periudha të

ndryshme historike luftuan dhe punuan për liri, pavarësi, identitet dhe dinjitet kombëtar.

28 Nëntori është një datë e bekuar për të gjithë ne shqiptarët.

Kjo ditë na kujton historinë tonë të lavdishme dhe sakrificën e shumë brezave për të qenë bashkë dhe të lirë.

Gjithashtu, vlerësojmë dhe i gëzohemi të arriturve të popullit shqiptarë kudo që jetojnë dhe punojnë, veçanërisht në progresin e arritur drejt rrugës euroatlantike, duke u shndërruar kështu në faktor të paqes dhe stabilitetit në rajon.

Zoti i bekoftë shqiptarët!



U.D. Kryeprokurori i Shtetit: Mungesa e buxhetit për sistemin prokurorial pamundëson efikasitetin e sistemit gjyqësor

Prishtinë, 29 Nëntor 2024 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka marrë pjesë në Konferencën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës “Ditët e Gjyqësorit”.



Gjatë fjalës së tij, U.D. Kryeprokurori Kelmendi ka përmendur sfidat e sistemit prokurorial, në veçanti ato që kanë të bëjnë me ndarjen e buxhetit nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ për të pasur një sistemin prokurorial funksional dhe efikas, me ç'rast ka theksuar se si pasojë e mos aprovimit të kërkesave buxhetore për të shtuar numrin e prokurorëve dhe stafit mbështetës do të vije deri të pamundësia e mbajtjes së seancave gjyqësore brenda afateve ligjore, për shkak të numrit disproporcional të prokurorëve dhe gjyqtarëve.



Tutje U.D. Kryeprokurori Kelmendi, nënvizoi qëndrimet lidhur me avancimin e sistemit të drejtësisë përmes bashkëpunimit institucional, duke theksuar rëndësinë e koordinimit në mes të sistemit gjyqësor dhe sistemit prokurorial, për të garantuar një drejtësi efikase dhe të besueshme në Republikën e Kosovës.

Në fund, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka falënderuar sistemin gjyqësor dhe partnerët ndërkombëtarë për mbështetjen e tyre gjatë reformës në drejtësi dhe ruajtjen e pavarësisë së sistemit të drejtësisë.



Konferenca e Këshillit Gjyqësor të Kosovës “Ditët e Gjyqësorit”, është organizuar me mbështetjen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Misioni në Kosovë, ku në ditën e dytë të kësaj gjykate kanë marrë pjesë gjyqtarë të lëmisë penale të gjykatave në Republikën e Kosovës.